

Shqipëria dhe Emiratet e Bashkuara Arabe forcojnë Marrëdhëniet Ekonomike

Shqipëria gjatë muajit Nëntor u shndërrua në qendër të bashkëpunimit ekonomik me Lindjen e Mesme, me një forum të organizuar nga AIDA. Delegacioni i Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA), i kryesuar nga Ministri për Tregtinë e Jashtme, Sh.T.Z. Thani Bin Ahmed Al Zeyoudi, përfshiu përfaqësues të kompanive elitare dhe solli mesazhe të qarta për rritjen e investimeve dhe shkëmbimeve tregtare.

Eventi përfshiu diskutime strategjike dhe bisedime B2B mes kompanive të fushave si energjia, teknologjia dhe ndërtimi, duke vendosur bazat për projekte të reja. Ndër pjesëmarrësit e delegacionit nga pala e Emirateve të Bashkuara Arabe ishin kompani si Masdar, JAFZA, ADNOC Global Trading, Kumo Industries dhe Oumolat.

Forumi konfirmoi Shqipërinë si një destinacion atraktiv për investime dhe një urë lidhëse drejt tregjeve evropiane, duke hapur rrugën për bashkëpunime të reja dhe një partneritet të qëndrueshëm ekonomik.



INVESTOR SUPPORT DAYS

Misioni i suksesshëm i Investors Support Days, gjatë muajit Nëntor u realizua tek AIDA me investorët Francezë, Austriakë dhe Hungarezë.

Ky mision është një mundësi e vlefshme për të identifikuar sfidat dhe për të propozuar hapa konkretë drejt një mjedisi më të qëndrueshëm dhe mbështetës për investorët.





INVESTOR SUPPORT DAYS

-  Në datën 05 Nëntor AIDA në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) dhe Ambasadën Franceze në Shqipëri, mbledhi përfaqësues të rëndësishëm nga biznesi dhe diplomacia për të adresuar sfidat dhe mundësitë për investorët francezë në Shqipëri.
-  Në datën 14 Nëntor, u zhvillua takimi i radhës Austrian Investor Support Day ku ishin pjesëmarrës përfaqësues nga MEKI (Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit), DPT (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve), përfaqësues nga Ambasada Austriake dhe biznese të mëdha austriake.
-  Në datën 19 Nëntor AIDA bëri bashkë investorët hungarez në Shqipëri, ku ishin të pranishëm znj. Blerta Rama, Zëvendësministre e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Sh. S. Znj. Martina Kasnyik, Ambasadore e Hungarisë në Shqipëri dhe përfaqësues nga Ministria e Financave.

Znj. Laura Saro, Drejtoresha ekzekutive e AIDA-s, gjatë takimeve theksoi gadishmërinë e AIDA-S për të realizuar projekt propozimet. Gjithashtu znj. Saro prezantoi projektet e fundit në bashkëpunim me Ministrinë dhe investorët potencialë, duke i ofruar mbështetje për zgjidhjen e problematikave të bizneseve të huaja që operojnë në Shqipëri.

Për AIDA-n, mbështetja për investorët e huaj është një element kyç në forcimin e marrëdhënieve ekonomike, duke ofruar një shembull të qartë të angazhimit për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe për të përmirësuar mundësitë për investime të huaja në vend.



Panairi Ndërkombëtar i 30-të i Tiranës 6-9 Nëntor



Në datat 06-09 Nëntor, në Tiranë, u zhvillua Panairi Ndërkombëtar i Tiranës, ku AIDA ishte prezente me stendën e saj përgjatë katër ditëve të zhvillimit të panairit.

Sic dihet tashmë, panairët cilësohen si vendet ku takohen ekspozuesit, blerësit dhe vizitorët, qëllimi i të cilit në thelb është të afrojë shitësit me blerësit, si edhe të promovojë dhe të lehtësojë tregtinë dhe shkëmbimin e eksperiencave.

Kjo platformë e suksesshme për zhvillimin ekonomik, ofroi mundësi të mëdha për promovimin e produkteve ose shërbimeve të një numri të konsiderueshëm biznesesh ndërkombëtare ku eksportuesit u takuan me importuesit. Si rrjedhojë kjo ka lejuar që shumë biznese të zgjerojnë shtrirjen e tyre dhe të ndërkombëtarizojnë ofertën apo markën e tyre.



Stenda e AIDA-s

Në ceremoninë hapëse të Edicionit të 30-të të Tirana International Fair, për të festuar tre dekada kontributesh të rëndësishme për peizazhin ekonomik të Tiranës dhe Shqipërisë, morën pjesë personalitete të rëndësishme të botës ekonomike dhe politike.

Znj. Laura Saro, Drejtor Ekzekutiv i AIDA, vlerësoi potencialin e këtij panairi për zhvillimin ekonomik dhe bashkëpunimin rajonal, nën moton "Shaping the future, beyond borders", që përshtatet dhe me misionin e AIDA-s.

Këtë vit, Panairi i Tiranës solli një atmosferë plot energji dhe inovacion, ku biznese nga rajoni dhe më gjerë prezantojnë arritjet dhe projektet e tyre më të fundit. AIDA morri pjesë me një stendë duke prezantuar 12 kompani shqiptare të artizanatit dhe agropëpunimit.

Tryeza e Bashkëpunimit Rajonal në edicionin e 30 të Tirana International Fair

AIDA ishte pjesë e Tryezës së Bashkëpunimit Rajonal në edicionin e 30 të Tirana International Fair, ku fokusi i diskutimeve ishte lehtësimi i barrierave financiare për tregtinë mes vendeve të Ballkanit dhe më gjerë.

Znj. Fiona Beqiri, përfaqësoi AIDA në këtë tryezë, ku theksoi se bashkëpunimi rajonal është një mundësi e mirë për rritjen dhe zhvillimin ekonomik, ku Shqipëria është e përkushtuar të ndërtojë ura lidhëse në të gjithë Ballkanin, duke shfrytëzuar burimet unike, pozicionimin strategjik dhe fuqinë punëtore të kualifikuar për të kontribuar në mënyrë domethënëse për një ekonomi rajonale të fuqishme dhe të bashkuar. Në këtë proces, ajo theksoi se AIDA është e angazhuar të tërheqë investime të huaja, të mbështesë SME-të dhe të promovojë eksportet.



Tryeza diskutimi gjatë panairit

AIDA ishte pjesë e një tryeze gjithëpërfshirëse mbi "Albania's convergence with the EU", që u mbajt gjatë Tirana International Fair.

Znj. Laura Saro, Drejtor Ekzekutiv i AIDA prezantoi nismat e agjencisë në kuadër të përfshirjes në tregun evropian. Rëndësi të veçantë në përpjekjet e shumta që AIDA po bën, zë krijimi i një Platforme të dedikuar për Eksportet, ku bizneset shqiptare do gjejnë ndihmën e duhur përmes saj.

Platforma do lançohet nga AIDA së shpejti.



Zgjidh të vendit

AIDA është në mbështetje të agropërpunuesve dhe të artizanatit, që përfaqësojnë traditën dhe shijen unike të produkteve "Made in Albania". Së bashku, nën nismën "Zgjidh të Vëndit" AIDA jep kontributin e saj maksimal për fuqizimin e mëtejshëm të agropërpunuesve dhe artizanëve tanë duke bërë të mundur arritjen e standarteve më të larta.

-Në Panelin e Diskutimit "Zgjidh të Vëndit" organizuar nga AIDA, gjatë Tirana International Fair me përfaqësues të politikbërjes dhe botës së biznesit, u theksuan sfidat dhe mundësitë e produkteve vendase në markën "Made in Albania" me synimin edhe drejt eksportimit të tyre.



AIDA, pjesë e forumit të ABSL 2024: “Europe at the Crossroads”

Gjatë datave 7-8 nëntor, përfaqësues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve morën pjesë në forumin ABSL 2024: “Europa në udhëkryq”.

Ky event i rëndësishëm, i cili u organizua në Porto, Portugali, ofroi një platformë për të eksploruar rrugë të reja për industrinë e shërbimeve të biznesit në Evropë dhe për të forcuar lidhjet ndërkombëtare. Gjatë forumit ekipi ynë zhvilloi takime të frytshme me AICEP Portugal Global dhe Invest Porto.

Gjithashtu, AIDA organizoi takim me ABSL për nxitjen e partneriteteve ndërkombëtare dhe pozicionimin e Shqipërisë si një destinacion strategjik dhe dinamik investimi në Evropën Juglindore gjatë të cilit u dakordësua nënshkrimi i një MoU.



Aksesi në Financë për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM)

Në Këshillin e Investimeve për prezantimin mbi “Aksesi në Financë për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) dhe Rekomandime për Përmirësimin e Instrumenteve të Financimit”, u diskutuan sfidat kryesore me të cilat përballen këto ndërmarrje në Shqipëri.

Seanca u përqendrua tek rëndësia e aksesit në financë për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e sipërmarrjes. U ndanë gjithashtu rekomandime për përmirësimin e skemave të garantimit të kredive dhe mbështetjen për bizneset e drejtuara nga gratë, duke nxitur një klimë më të barabartë dhe të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik.



AIDA mirëpriti në takim Ambasadorin e Çekisë

Znj. Laura Saro, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA), mirëpriti në takim Sh.S.Z. Pavel Vacek, Ambasador i Çekisë në Shqipëri, i shoqëruar nga Atasheu i Ekonomisë për të diskutuar rreth mundësive për rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe investimeve mes Shqipërisë dhe Çekisë.

Znj. Saro vlerësoi marrëdhëniet e mira ndërmjet dy vendeve dhe nënvizoi rolin e AIDA-s në lehtësimin e projekteve të përbashkëta.

Ambasadori Vacek theksoi përkushtimin e Çekisë për të mbështetur iniciativa që nxisin zhvillimin ekonomik dhe shkëmbimin e përvojave në fusha me interes të përbashkët, duke shprehur interesin për të rritur prezencën e kompanive çeke në Shqipëri.


Moody's - Ekonomia shqiptare rritje e qendrueshme

Agjencia ndërkombëtare e vlerësimit të kreditit "Moody's" ka rishikuar vlerësimin e saj, duke vlerësuar me rritje perspektivën e Shqipërisë nga "B1- me perspektivë pozitive" në "Ba3 - e qëndrueshme".

Moody's parashikon një rritje të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatmesme, të nxitur nga financimet e Bashkimit Evropian dhe zbatimi i reformave përkatëse.

Investimet e huaja direkte, veçanërisht në sektorët e turizmit dhe energjisë, pritet të luajnë një rol kyç, ndërsa transformimet sektoriale synojnë të nxisin produktivitetin.

Këto ndryshime pritet të përmirësojnë ekonominë duke zhvendosur fuqinë punëtore nga bujqësia drejt sektorëve më produktivë, si turizmi.



Gjatë nëntorit 2024, në kuadër të programit Grow Albania LOCAL, kemi realizuar një sërë aktivitetesh për mbështetjen e NMVM-ve shqiptare. Organizuam një webinar mbi përgatitjen e biznesit për tremujorin e fundit të vitit dhe ofruam konsulta falas për planifikimin dhe menaxhimin efektiv të burimeve. Përmes postimeve informuese, ndamë këshilla mbi rëndësinë e marketingut dixhital dhe përmirësimin e prezencës online.



AIDA organizon misionin e parë tregtar në Varshavë, Poloni

AIDA, në bashkëpunim me Ambasadën Shqiptare në Poloni dhe PAIH (Polish Trade and Investment Agency), organizoi për herë të parë një mision tregtar në Varshavë, gjatë datave 18 - 19 nëntor 2024. Ky mision kishte si qëllim identifikimin e partnerëve polakë dhe tregjeve të reja për kompanitë shqiptare, duke krijuar mundësi të reja për bashkëpunim ekonomik midis dy vendeve.

Përfaqësuesi i AIDA mbajti një prezantim të detajuar mbi mundësitë e investimeve në Shqipëri, potencialin që vendi ofron dhe incentivat tërheqëse për investorët e huaj. Gjithashtu, u zhvilluan takime të suksesshme B2B mes kompanive shqiptare dhe atyre polake, duke krijuar ura të reja bashkëpunimi. Delegacioni shqiptar përbëhej nga kompani që operojnë në sektorin e bimëve medicinale dhe prodhimit të produkteve të kujdesit të lëkurës.

Ambasadorja e Shqipërisë në Poloni, H.E znj. Mimoza Halimi, priti delegacionin shqiptar në Ambasadën Shqiptare në Varshavë, duke theksuar rëndësinë e këtij misioni për forcimin e marrëdhënieve dypalëshe.



Vizita aftercare pranë kompanisë Forscher Albania

Në kuadër të misionit të përkujdesjes ndaj investorëve, AIDA realizoi vizitë pranë kompanisë Forscher Albania.

Znj. Laura Saro, Drejtor Ekzekutiv i AIDA, e shoqëruar nga stafi i sektorit Aftercare, vizitoi kompaninë Forscher Albania, duke u njohur nga afër me sfidat dhe mundësitë e këtij investimi të huaj në vendin tonë.

AIDA është gjithmonë në mbështetje të investimeve në Shqipëri, duke lehtësuar këtë proces.



Ftesë për pjesëmarrje 08-10 Mars 2025 “FOOD EXPO”, Athinë Greqi

AIDA për herë të dytë do të jetë me standë të Shqipërisë në panairin Food Expo, dedikuar sektorit të produkteve ushqimore dhe pijeve.

Workshop “Mbi teknologjitë e prodhimit dhe digjitalizimin e prodhimit” si pjesë e programit AMTECH

Shoqata PROEKSPORT Albania organizoi më 26 Nëntor në Tiranë Workshop-in “Mbi teknologjitë e prodhimit dhe digjitalizimin e prodhimit” si pjesë e programit AMTECH, mbështetur nga Interreg IPA i Adriatikut të Jugut.

Ky programi synon të promovojë teknologjitë e avancuara industriale për të përmirësuar konkurrencën e NMVM-ve dhe për të zhvilluar një model ekonomik më të qëndrueshëm në rajon. Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve Znj. Laura Saro, theksoi se, AIDA është e përkushtuar të mbështesë projektet si AMTECH pasi theksojnë aplikimet praktike të këtyre teknologjive për të mbështetur NVM-të që të jenë inovative dhe konkurruese në një treg gjithnjë e më dinamik.

